

Atë Robert DeGrandis S. S. J.

Dhurata e gjuhëve

Titulli i origjinalit:
"The gift of tongues"

Titulli në kroatishte:
Dar Jezika

Përkthyen:
m. Svjetlana Rezo F.D.C. dhe
Gjon Kelmendi ida

Redaktimi gjuhësor:
Prend Buzhala

Kopertina:

Përmbajtja

Përmbajtja	-----
Parathënie	-----
Parathënie botimit shqip	-----
Dhurata e gjuhëve të ndryshme	-----
Metoda e punës	-----
Si të aktivizohet dhurata e gjuhëve	-----
Gjuhët në shërbim dhe gjuhët e lutjes	-----
Dhurata është nën kontrollin e personit	-----
T'ia japim veten dhuratës së gjuhëve	-----
Përmbledhja	-----
Dëshmi personale	-----

PARATHËNIE

Në këtë libërth përfshihen ligjëratat që i kam zhvilluar në Londër gjatë verës së vitit 1980, ku brenda shtatë ditësh mbajta një seminar për edukuesit. Ata që kanë qenë të pranishëm në seminare të ngjashme, do ta shohin në këtë libërth po atë metodë, të cilën unë e përdor për t'i ndihmuar njerëzit për të arritur përvojën e dhuratës së gjuhëve të ndryshme. Përvoja ime shumëvjeçare ka vërtetuar se kjo metodë është efektive.

Shpresoj sinqerisht se udhëheqësit do ta vlerësojnë këtë metodë si të frytshme për bashkësitë e tyre të lutjeve, që t'u ndihmojnë atyre që ende nuk luten në gjuhë të ndryshme. Gjithashtu, shpresoj, që, ju që do ta lexoni këtë libërth, por nuk jeni lutur kurrë në gjuhë të ndryshme; do të fitoni guxim të hyni në përvojën e kësaj dhurate të rëndësishme të Shpirtit të Shenjtë.

Autori

Parathënie botimit shqip

Ja, të dashur lexues, ju sjellim librin mbi dhuratën aq të mrekullueshme të Shpirtit Shenjt „Dhuratën e gjuhëve“. Duke iu falënderuar „Ungjillëzimit të ri“, kjo dhuratë është sot e pranishme dhe shquhet te miliona karizmatikë.

Në kohët e fundit Radio Vatikani e ka publikuar një informatë, sipas të cilës në atë lëvizje të përtëritjes shpirtërore janë të regjistruar 130.000.000 vetë. Nëpërmjet dhuratës së lutjes, shumëkush ka arritur fenë e thellë dhe ndryshimin e jetës së vet, ashtu si thotë Shën. Pali: Ai që lutet ndërton veten...

Shkencëtarët në SHBA, pas hulumtimeve, kanë konkluduar se ata që e posedojnë këtë dhuratë, kanë më shumë qëndrueshmëri psikike. Falënderoj Zotin e dashur për Bashkësinë e lutjes në Prishtinë, që me dashuri e përcjell që nga viti 1982. Atë vit, kur duhej të shkoja për ndonjë punë, planifikoja të gjendesha atje në kohën e lutjes, e cila më lartësonte shpirtërisht në veprimin tim konkret nëpër terrenet malore të famullisë së Stubllës, në Dunav.

Atë vit, në lutje, kishte pjesëtarë nga tetë kombe, disa prej të cilëve ishin studentë tuaj, e, madje, në mesin e tyre, gjendej edhe një kinez, që duhej të bëhej folës i Radio Pekinit. Mund të merret me mend se çfarë dhurate ishte për popullin e vet, që dikush të kthehej nga studimet i mbushulluar me Shpirtin Shenjt! Kështu, në atë Bashkësi të vogël lutjesh, i

madhi Zot ka bërë vepra të mëdha. Aty, shumëkush ka ndryshuar nga Sauli në Pal.

Fatkeqësisht, duke mos qenë e njohur sa duhet, kjo dhuratë e mrekullueshme përqeshej shpesh, si edhe shumë dhurata të tjera të Shpirtit Shenjt, sepse atë që nuk e njohim edhe nuk mund ta vlerësojmë.

Në kapitullin e 14-të të Letrës së Parë Korintasve, shën Pali na thotë: „Ai që flet në gjuhë të huaj arsimon veten...Do të dëshiroja që të gjithë të flisni në gjuhë të ndryshme...Kështu edhe ju, pasi dëshironi me gjithë zemër t'i keni dhuratat e Shpirtit, bëni çmos t'i keni me sasi të mëdha për edukimin e Kishës.“ Dmth, nëse dhurata ime më ndërton mua, kurse dhurata jote ty, atëherë ndërtohet Kisha. Dhe, sipas tij, kjo dhuratë ndërton brendinë e atij që e posedon, shën Pali e thotë për vetveten në rreshtin e 18-të, se flet brenda kësaj dhurate më shumë se të gjithë të tjerët. Dihet, po ashtu, se këtë dhuratë e ka pasur edhe Papa Gjon Pali II. A thua, ka të atillë që janë rritur aq shumë shpirtërisht sa që kjo dhuratë nuk u duhet?

Të dashur lexues, mund të dëshmoj edhe vetë, se shumë njerëzve u ka ndihmuar që ta përjetojnë një dimension më të thellë të jetës së tyre shpirtërore, të ruajnë paqen, ose ta gjejnë atë në çdo situatë. Pra, kërkoni e do t'u jepet...

Falënderoj zonjën Ruzha Andriq që ka sponsorizuar këtë botim. Libri nuk shkon në shitore, por tek jetët e njerëzve. Do të shpërndahet në qendrat shpirtërore, ku mund ta marrin të interesuarit, ta lexojnë dhe ta kthejnë në mënyrë që edhe të tjerët ta kenë në dorë.

Lutem për dritën e Shpirtit Shenjt me të gjitha dhuratat që ka i dashuri Zot, për çdo njeri që do ta marrë këtë libër.

m. Svjetlana Rezo FDC

Dhurata e gjuhëve

Dhuratat janë të ndryshme, por Shpirti Shenjt është i njëjtë – edhe shërbesat në përhapje të Ungjillit janë të ndryshme, por Zoti është i njëjtë – secili merr dhuratë të veçantë të zbulesës së Shpirtit Shenjt për të mirën e përbashkët. Dhe njëmend, Shpirti Shenjt i jep njërit fjalën e urtisë, kurse i njëjti Shpirt Shenjt një tjetri i jep fjalën e dijes; po i njëjti Shpirt Shenjt dikujt i jep fenë, një tjetri prapë, i njëjti Shpirt Shenjt, i jep dhuratën e shërimit; tjetrit pushtetin për të bërë mrekulli, një tjetri profecinë, një tjetri aftësinë të dallojë shpirtrat, një tjetri zotësinë e gjuhëve të ndryshme, një tjetri shtjellimin e gjuhëve. E, të gjithë këto, i bën një i vetmi Shpirti Shenjt, duke i ndarë veçanërisht secilit ashtu si Ai do. (1 Kor 12, 4-11).

Në këta rreshta biblikë shihen nëntë dhurata të Shpirtit Shenjt si i përshkruan Shën. Pali. Në punën tonë fokusohemi në dhuratën e gjuhëve të

ndryshme, duke mësuar se si hyhet në përvojën e kësaj dhurate dhe duke theksuar vlerën e kësaj dhurate për të krishterët e sotëm.

Për Shën Palin dhurata e gjuhës është së pari dhuratë për lutjen personale. Sepse, ai që flet gjuhë të ndryshme, flet me Hyjin e jo me njerëz: (1 Kor 14,2) Personi që lutet nuk kupton çka flet, mendja e tij nuk ka prej kësaj dobi (1 Kor 14,4), por prapë se prapë ai e përsos veten shpirtërisht (1 Kor 14,4), sepse lutet me Shpirt, dhe, me anë të Shpirtit, flet gjëra të fshehta (1 Kor 14, 2). Fjala “e përsos” këtu do kuptuar mirë; ajo nënkupton përsosjen e personit që lutet në gjuhë të ndryshme. (Malcolm, C.P. The gift of tongues today).

Metoda e punës

Gjatë kohës sa kam qëndruar në Çile më 1977, një meshtar, i cili ka qenë i pranishëm në periudhën e hyrjes në përvojën e dhuratës së gjuhëve të ndryshme, ka pohuar se kjo është metoda më e mirë, të cilën ai e ka parë ndonjëherë. Ajo është me të vërtetë e thjeshtë: në fillim shpjegojmë dhuratën e gjuhëve të ndryshme; lutemi për personin që brenda tij të çlirohet kjo dhunti dhe, në fund, personi hyn në përvojën e kësaj dhurate.

Shumë herë dëgjojmë ligjëratat të shkëlqyeshme nga njerëz të ditur, por shpesh nuk na japin udhëzime praktike, se si idetë dhe përmbajtjet e fjalimeve të tyre të zbatohen në jetën personale. Me këtë metodë nuk do të ndodhë ashtu; për deri sa do të lexoni, jo vetëm që do të mësoni diçka mbi dhuratën e gjuhëve, por do ta pranoni dhe me te do ta pasuroni jetën tuaj.

Është shumë e rëndësishme ajo që e bëjmë gjatë udhëzimeve tona, madje edhe për ata që luten në gjuhë të ndryshme. Kjo metodë kërkon qasje me shumë kujdes dhe pastaj do përdorur në bashkësinë tuaj të lutjeve. Nuk ka asnjë arsye që çdo anëtar i çfarëdo bashkësie të lutjeve mos të hyjë në përvojën e lutjes së gjuhëve të ndryshme, për më së shumti dy javë. Ju ofroj mjetin me të cilin mbarë bashkësinë e lutjeve mund ta ngrini në një nivel më të lartë të jetës shpirtërore, ku dhuratat shpirtërore do të jenë të pranishme në jetën e tyre. Para disa kohësh në revistën *New Covenant* është botuar ky artikull:

Sipas mendimit tim, në Kishë pas koncilit II, më së shumti është i nevojshëm mbushullimi me dhuratat shpirtërore. Jo pse dhuratat e gjuhëve të ndryshme, apo ato të profecisë dhe të shërimit të jenë qëllim më vete. Më së shumti na nevojitet dhurimi i zemrave tona Zotit. Sa më shumë që t'i afrohem Zotit, aq më shumë do t'i kushtohemi Shpirtit Shenjt dhe sa më shumë fuqi të kemi nëpërmjet të dhuratave të shpirtit, aq më shumë energji ë tilla Zoti do të lirojë brenda nesh. Kemi provuar programe të shumta, ripërtëritje, vikende të përbashkëta apo kurse, kemi dëgjuar mësim të shumta nëpërmjet kasetash etj. Por ajo çka na nevojitet më së shumti janë Shpirti Shenjt dhe dhuratat e tij (*New Covenant*, qershor 1981.) Këto fjalë janë shumë të rëndësishme dhe për to duhet të mendojmë me kujdes.

Në të vërtetë, duhet të veprojmë kështu:...që feja juaj të mos themelohej në dijen e njerëzve, por në fuqinë e Hyjit (1 Kor 2,5). Është Gabim i madh i shumë udhëheqësve të bashkësive të lutjeve, sepse vetë nuk kanë hyrë më thellë në dhuratat shpirtërore. Shumë nga ata përpiqen që me anë të fuqive njerëzore t'i mësojnë të tjerët dhe t'i ngritin shpirtërisht; nganjëherë të gjitha mundimet e tyre nuk sjellin fryte. Me këtë mund të shpjegohen edhe tendosjet e shpeshta që ndodhin në mes të udhëheqësve. Udhëheqësi ideal[

në grupin e lutjeve është personi shpirtëror që “lëviz” lirisht në fushën e dhuntive shpirtërore.

Në Enciklikën mbi Ungjillëzimin, Shenjti Atë Papa Pali VI në artikullin 75 shkruan kështu: “Qëllimi është që Shpirti Shenjt të na përfshijë tërësisht dhe të na udhëheqë.” Në librin tim Rritja në Shpirtin Shenjt, pikërisht këtë e kam theksuar si qëllim i çdo të krishteri - që të jetë i kapluar nga Shpirti Shenjt. Një teolog më ka shkruar: “Diçka e tillë është e pamundur. Nuk mund të jemi të kapluar nga Shpirti Shenjt”. Pesë vite ky libër nuk ka mundur të botohet, sepse ky teolog nuk ka qenë dakord me këtë konstatim.

Ua porosit të gjithë udhëheqësve këtë metodë pune; bisedoni me njerëz mbi këtë metodë, mësojini. Gjatë punës lutuni për njerëz - lutuni që të largohen pengesat shpirtërore. Provoni që t’i sillni në atë gjendje ku ata do të mund t’i dorëzohen Shpirtit Shenjt. Gjithmonë ta keni parasysh se ju nuk mund t’i mësoni njerëzit të lutën në gjuhë të ndryshme; si të profetizojnë; nuk mund t’i mësoni si t’i shërojnë të sëmurët, ashtu si i mësojmë fëmijët për të lexuar. Por, mund t’i mësojmë si do ta lëshojnë veten në duar të Shpirtit Shenjt. Këtu është dallimi kryesor. Në këtë libër do të tregojmë si do t’i përkushtohemi Shpirtit: ashtu do të mund t’i mësoni të tjerët.

Themeli i këtij mësimi përbën çështjen rrënjësore: çka është pagëzimi me Shpirtin Shenjt? Unë do ta krahasoja me përvojën fetare, kur krejtësisht i përkushtohemi Shpirtit Shenjt, Zotit, ashtu si i jepemi sakramentit të martesës. Në sakramentin e martesës burri i ardhshëm dhe gruaja e tij thonë: “Unë po të marr për gruan time. Po të marr për burrin tim”. Dhurimi është i dyanshëm.

E njëjta gjë ndodh në pagëzimin me Shpirt. Vetën ia dhuroj Zoti; ai na dhurohet rishtas në Shpirtin Shenjt. Atëherë brenda nesh lirohen dhe ngjallen nëntë dhuratat e Shpirtit Shenjt, të cilat janë përmendur në 1 Kor 12: dhurata e gjuhëve, shtjellimi i gjuhëve, profecia, urtia, dhurata e dijes, dallimi i shpirtëve, dhurata e mrekullive, dhurata e fesë dhe dhurata e shërimit. Këto dhuratat janë vegla të nevojshme për jetën e krishterë. Ato gjallërohen në pagëzimin me Shpirt.

Si të bëhet aktive dhurata e gjuhëve

Te secili person që është i pagëzuar me Shpirtin Shenjt, është e pranishme pasuria e nëntë dhuratave të Shpirtit Shenjt. Ndoshta do të thoni: “Si e di ti këtë?” Përgjigjja ime është: “E di sipas përvojës sime”. Kur gjatë

punës me njerëz, ua them këto fjalë: "Ju jeni pagëzuar me Shpirtin Shenjt dhe dhuratat e gjuhëve janë aktive te ju." Tani këtë do të bëjmë praktikisht". Ata pyesin: "Si?". "Asisoj, që ju do t'i përkushtoheni dhuratës që është brenda jush" u përgjigjem.

Shembull i qartë, se si dhurata brenda nesh bëhet vepruese, është dhurata e shërimit. Ajo është aktive te të gjithë, por nuk është vepruese për deri sa nuk i shtrijmë duart mbi të sëmurët dhe të lutemi për shërim.

A e ka pasur ndonjëri prej jush këtë përvojë? I shtrini duart mbi një person, luteni për shërim dhe ai papritmas shërohet. Atëherë ju jeni i befasuar me atë që ka ndodhur.

Me fjalë të tjera, kjo dhuratë ka qenë te ju aktive. Keni bërë diçka me çka i jeni përkushtuar kësaj dhurate dhe ajo është bërë vepruese. Është e njëjta gjë me gjuhët. Dhurata e gjuhëve është aktive secili i krishterë, i cili është pagëzuar me Shpirtin Shenjt. Në punën tonë, me ata të cilët thonë: "Kurrë nuk jam lutur në gjuhë të ndryshme", kemi formuar rrethin, jemi lutur me ta dhe në fund u kemi thënë: "Mirë. Tani përkushtojeni veten.". Do t'ju tregoj si do ta jepni në kushtim veten. Është shumë e thjeshtë. Është aq thjeshtë saqë duket marri. Por, Hyji zgjodhi atë që është e marrë në sytë e botës për t'i turpëruar të mençurit. (1 Kor 1, 27). Do të ju sjellim deri në pikën e dhurimit dhe atëherë është radha juaj që të lëshoheni.

Gjatë shpjegimit të gjuhëve të ndryshme mund t'u flasim 45 minuta, për t'i futur në këtë dhuratë dhe pastaj u rekomandojmë që të lexojnë disa libra në këtë temë. Teoria ime nënvizon se personi, i cili e përjeton përvojën e gjuhëve të ndryshme, dëshiron të lexojë më shumë për sa i përket kësaj teme. Zakonisht, dikush që lexon libër mbi dhuratën e gjuhëve të ndryshme, do të hyjë në këtë dhuratë gjatë leximit. Shumë njerëz kanë filluar të flasin në gjuhë të ndryshme pas leximit të librit të John Sherrill: Ata flasin në gjuhë të ndryshme. Ky është libër mjaft i gjatë; duke lexuar, ata mendojnë, lutën, presin dhe në fund ajo edhe ndodh. Dhurata, e cila ka qenë brenda nesh aktive, tani bëhet vepruese. Një grua afariste e ka dhënë dëshminë e vet: dëshira për lutje në gjuhët e ndryshme, te unë është paraqitur pas leximit të librit të John Sherrill-it. Ata flasin në gjuhë të ndryshme. Në bashkësitë e lutjeve, në të cilat kam marrë pjesë, njerëzit kanë lutur në gjuhë dhe kjo nuk ka qenë e panjohur për mua, por në mes njerëzish kam qenë e frikësuar dhe e ngatërruar. Nuk kam mundur të këndoj ose të lutem me zë të lartë. Kur kam qenë vetëm në makinën time gjatë rrugës, gjithmonë kam kënduar Ti je I Shenjtë o Zot, haleluja. Një ditë gjatë vozitjes - nuk kam menduar për asnjë gjë të veçantë, vetëm kam kënduar - dy tri rrokje m'u kanë "përzier" në këngën time. Kjo më ka befasuar aq shumë, sa që gati kam bërë aksident. Më së pari kam shikuar përreth vetes: a më ka parë dikush, natyrisht se jo, pasi isha vetëm në makinë. Kam provuar t'i kujtoj ato rrokje, të cilat i kam shqiptuar. Deri sa kam kënduar, të njëjtat rrokje janë përsëritur. E kam ndaluar makinën duke i përsëritur. Kam qenë e frikësuar që ato rrokje të mos

humbin. Madje edhe i kam shkruar. Nuk kam mundur të besoj se unë po lutem në gjuhë. Këto rrokje i kam përsëritur sa herë më është dhënë rasti i volitshëm, posaçërisht gjatë vozitjes ose duke bërë dush. Edhe më tej kam pasur turp të lutem përpara të tjerëve, por me kohë më kanë ardhur fjalë të tjera dhe gjuha ime është zhvilluar. Kështu është rritur edhe feja ime me këtë dhuratë, e cila vepron te unë dhe nëpër mua. Faleminderit Ty o Jezu! Me të vërtetë e falënderoj Zotin për dhuratën e gjuhëve. Është treguar si dhuratë e shkëlqyeshme, posaçërisht kur lutem për vete ose për të tjerët kur nuk di si të lutem. Tani e tëra duket aq thjeshtë - thjeshtë t'i lejohet Shpirtit që të lutet në ty. Më ka ndihmuar për të qenë e hapur ndaj dashurisë së Zotit dhe shërimit, si edhe për dhuratat tjera Shpirtërore. Vërtetë besoj me gjithë zemër se kjo dhuratë na bën të hapur Shpirtit Shenjt dhe lutem çdo ditë në gjuhë.

Jessie

Gjuhët në shërbim dhe gjuhët e lutjes

Gjuha e lutjes është dhuratë e përhershme, me të cilën ndërtohet vetvetja. Shpirti lutet brenda teje, si shkruan në letrën Romakëve 8,26: Kështu, pra, edhe Shpirti Shenjt na ndihmon kundruall paaftësisë tonë, sepse ne nuk dimë as çka të kërkojmë me lutje si duhet, por vetë Shpirti Shenjt lutet për ne me ofshamë të patregueshme.

Dhuratë e gjuhës në shërbim të të tjerëve, është “të folurit” në gjuhë, kur, duke folur gjuhën time të lutjes, i shërbej bashkësisë. Ka një dallim. Qëllimi themelor i lutjes në gjuhë, qëndron në lavdërimin e Zotit. Kur lavdërojmë Zotin, duke u lutur në gjuhë të ndryshme, është i mundur shtjellimi i gjuhës ose profecia për ndërtimin e bashkësisë. Dhurata e gjuhëve të ndryshme është dhuratë e përhershme.

Përndryshe, të folurit në gjuhë, është dhuratë që vepron vetëm me shugurim të posaçëm. Ja një shembull: sot jam lutur në gjuhë në kapelë, kur isha vetëm. Kur kam ardhur në takimin e lutjes, kam pasur frymëzim dhe jam lutur në gjuhë: dikush pastaj e ka shtjelluar lutjen time në gjuhë të ndryshme. Ekziston ndryshimi në mes këtyre dy shembujve.

Tani shtrohet pyetja, “Çka është dhurata?” Dhurata, ashtu si e shoh unë, është gjendja pasive në të cilën jemi të hapur para Shpirtit Shenjt. Nuk është e mundur që të “kyçet” dhurata e shërimit, e profecisë ose e gjuhës. Por, mund të jem i hapur ndaj Shpirtit Shenjt dhe të them: “Zotëri, këtu jam. Më përdor si dëshiron ti”. Nga përvoja e dimë se Zoti pikërisht këta persona i përdor shpesh. Nëse jemi të hapur ndaj Shpirtit dhe jemi pasivë, Ai do të na përdorë për qëllimet e veta. Shumë njerëz nuk e dëshirojnë këtë. Zoti kërkon zemrën e hapur, e cila dëshiron që Ai të veprojë nëpërmes saj.

Lutja në gjuhë të ndryshme është lutje në gjuhë, e cila nuk është gjuhë amënore e atij që lutet. Kjo lutje është nga Shpirti Shenjt. Ajo është nën kontrollin e lutësit dhe të vullnetit të tij të lirë; i përdor mjetet natyrore të folurit njerëzor. Këtë lutje lutësi nuk e kupton, dmth. mendja nuk ka pjesëmarrje në të. Dhurata e lutjes është dhuratë e përhershme dhe mund të përdoret sipas dëshirës së personit që lutet.

Është fjala për gjuhë të panjohura. A janë këto gjuhë moderne? Besoj se në disa raste me të vërtetë janë. Më 1971, gjatë kohës së lutjes në New Orleans, personi afër meje lutej në gjuhë të ndryshme. E pyeta: "A e keni studiuar latinishten?" Ai u përgjigj: "Jo". E pyeta përsëri: "A keni dëgjuar latinishten në ndonjë ligjëratë?" Ai më tha : "Jo". Atëherë i thashë: "Ju jeni lutur në gjuhën e përkryer latine dhe kam kuptuar çdo fjalë që keni folur". Motra ime ka pasur përvojë të ngjashme kur një meshtar nga Portugalia e ka pyetur: "Dottie, a flitni portugalisht?" Ajo i ka thënë: "Jo". "A e dini se jeni lutur në portugalisht? Keni thënë ' O Mari, e ngritur në më të lartin qiell, na ndihmo që ta njohim Birin tënd'."

Domethënë, nganjëherë gjuha e lutjes mund të jetë gjuhë moderne, por më shpesh kjo është gjuhë që nuk është amtare, dhe nuk është gjuhë e gjallë që përdoret diku. Ati Robert Faricy thotë kështu: "Kur lutem në gjuhë, belbëzoj; nga ana linguistike kjo është e pakuptimtë, fjalë të pakuptueshme. Kuptimi nuk është i zëshëm as tek fjalët që paraqesin koncepte. Kuptimi i lutjes në gjuhë qëndron në zemër, sepse gjuha e lutjes nuk është gjuhë e kuptimit. Zërat nuk janë fjalë; ato nuk kanë domethënie kuptimore. Për mendjen tonë, këto rrokje s'kanë kuptim. Lutja në gjuhë është verbale, por jo lutje kuptimore. Ajo është kontemplacion me zë".

Dhuratat e gjuhëve mund të quhen edhe "frymëzim para-kuptimor". Mund ta sqarojmë edhe kështu: sapo lind fëmija, mjeku e godet në prapnicë. A mendon atëherë ai fëmijë: "Më shiko, çka do të bëj tani? Pasi që më kanë rënë, do të duhej të qaja?" A thua do të mendojë para se të qajë? Nuk ma merr mendja. Kur luajmë me fëmijën e vogël, a mendon ai: "Përse të gjithë këta njerëz prodhojnë këta zëra të çuditshëm, kur janë me mua? Ndoshta u dashka t'i imitoj që të jenë të kënaqur?" Fëmija nuk ka nevojë ta mësojmë për këto gjëra; ai reagon në mënyrë instiktive. Nuk nevojitet ta mësojmë për të qarë ose për të qeshur. Këtë krahasim dëshiroj për ta theksuar, kur është fjalë për gjuhën si "frymëzim para-kuptimor". Gjuhët janë lëvizje spontane e zemrës njerëzore drejt Zotit; nëpër këtë lëvizje, Shpirti Shenjt mund të hyjë.

Mos të përpiqemi shumë të gjejmë shpjegime të arsyeshme për të gjitha. Këtu qëndron edhe një fshehtësi e vogël. Kur ulem në Fordin tim, fus çelësin në bravë, këmbën në pedalin e lëndës djegëse dhe nisem: nuk di asgjë mbi cilindrat, pistonat, kandelat dhe karburatorët. A duhet të di? E di si do ta fus çelësin në bravë, t'ia shkel dhe të nis makinën. Shumë vozitës nuk dinë asgjë mbi faktin se çka e lëviz makinën, por dinë si të vozisin.

Nuk mund të ju sqaroj detajet intime dhe thellësinë në lidhje me gjuhët e ndryshme. Dyshoj se dikush do të mund ta bënte këtë. Shumë vetë mund të supozojnë ose ta parandiejnë, por askush nuk mund ta sqarojë bërthamën. Sikurse nuk mund të ju sqaroj çka ndodhë gjatë Meshës kur e marr bukën dhe verën dhe them: "Ky është korpi im. Ky është gjaku im". Në mënyrë teologjike mund të spekulojmë, por nuk mund ta shpjegoj thelbin. Por e di çka ndodh, dhe këtë e di me anë të fesë. Do të ju ndihmoj që t'i jepeni me përkushtim dhuratës së gjuhëve, dhe pastaj do të ju lë që të mendoni vetë. Është e rëndësishme që këtë ta provoni vetë. Ja një citat prej librit *Dhuratat shëruese të Shpirtit* të Agnes Stanford:

Nëse personi krejtësisht e harron veten dhe mendjen e vet e fokuson tek Zoti, duke lejuar që fjalët të rrjedhin lirshëm, atëherë kjo dhuratë bëhet terapi e shkëlqyeshme për shërimin e shpirtit. Sepse Zotin e thërrasim nga thellësia; Zoti, i cili banon në thellësitë e qenies njerëzore, dëgjon lutjen tonë dhe na vërshon me dashuri, të cilën më parë nuk e kemi njohur. Për më tepër, kur nuk dimë si të lutemi, Shpirti lutet brenda nesh 'me ofshama të patregueshme', ose do të mund të thoshim me tinguj, të cilët nuk mund t'i shprehim me gjuhën tonë – dhe na jep një njohje të qartë se nga thellësitë tona të pavetëdijshme lutemi në përkim me vullnetin e Zotit. Nga ndjenjat që e përcjellin lutjen tonë, e dimë se jemi ngritur më afër qenies së Tij se ç' kemi pasur mundësi, të lidhur me prangat e gjuhës që e kuptojmë.

Si e dimë që dhurata e gjuhës vjen nga Shpirti Shenjt? Përgjigjja është e lidhur me pyetjen: "Çka është Kisha?" Çka do të thotë të jesh katolik? Duhet të besojmë që Jezusi e ka themeluar një bashkësi, bashkësinë e njerëzve të bashkuar në Të në mënyrën më intime – Kishën e vet. Në Kishë ka lënë personat udhëheqës dhe barinjte, të cilët kanë për detyrë të vlerësojnë se çka vjen prej Zotit e çka jo – me frymëzimin e Shpirtit Shenjt, që është, sipas mendimit tim, shumë e rëndësishme. Kjo Kishë, të cilën e ka themeluar Jezu Krishti, ka vërtetuar: "Ripërtëritja Karizmatike është vepër e Shpirtit Shenjt që vepron në ditët e sotme". Në bazë të këtij fakti, mund ta kemi sigurinë absolute se gjendemi në rrugë të drejtë.

Kisha e vërteton se lutja në gjuhë të ndryshme vjen nga frymëzimi i Shpirtit Shenjt. Ndoshta është e mundur që të gjendet ndokush, "dhurata" e të cilit është e rrejshme, por Kisha, me pranimin e Ripërtëritjes Karizmatike, thotë se gjuhët janë me të vërtetë dhuratë e Zotit. Të jesh katolik, do të thotë: të ndjekësh mësimin e Korpit të Krishtit, Kishës.

Nganjëherë njerëzit më thonë: "Nuk besoj në të gjitha këto sende karizmatike". Atëherë, zakonisht unë u them: "Mendoj se nuk qëndron problemi te Ripërtëritja Karizmatike. Problemi është se ti nuk i pranon mësimet e Kishës". Ata zakonisht kundërshtojnë: "Unë jo". Atëherë vazhdoj: "Pikërisht ti, sepse Kisha mëson se Ripërtëritja Karizmatike është vepër e Shpirtit Shenjt. Ripërtëritja është bekuar nga dy Papë e nga shumë ipeshkvij, së bashku dhe veçmas, në shumë shtete të botës".

Njëherë kam qenë i pranishëm në një tubim të kishës, në të cilin kanë qenë katër ipeshkvij dhe disa eprorë të lartë. Një kardinali iu drejtua pyetja: "A është e vërtetë se në Amerikë ekziston teoria që Ripërtëritja Karizmatike është e pranuar në përgjithësi, sepse është vërtetuar nga dy Papë dhe nga ipeshkvijtë?" Para të gjithë të pranishmëve, meshtarëve, ipeshkvijve, karizmatikëve dhe të tjerëve, ky kardinal është përgjigjur: "Absolutisht po! Ripërtëritja është bekuar nga Shenjti Atë Papë". Atëherë ka vazhduar dhjetë minuta duke cituar ligjëratat dhe dokumentet e Papës. Pastaj u bë pyetja: "Nëse është ashtu, pse nuk vërehet në nivelet lokale?" Atëherë ai u ndal, duke u gjetur në një situatë të palakmueshme. I kam harruar argumentet të cilat atëherë i ka dhënë, por atë që ka përsëritur disa herë, është se Ripërtëritja e ka bekimin nga ana e Kishës. Si katolik, kjo na jep siguri se Ripërtëritja është vepër e Shpirtit Shenjt; përndryshe, do të mund të thoshim se Kisha na shpie në rrugë të gabuar dhe bën gabim të madh në gjëra shumë të rëndësishme, lidhur me urdhrin e parë të Zotit.

Nëse lutja e gjuhëve si dhuratë nuk vjen nga Shpirti Shenjt, atëherë Kisha na çon në rrugë të gabuar; atëherë, në vend që ta lavdërojmë Zotin, ne lutemi gabimisht. Me këtë gjë nuk mund të jem dakord. Kisha duhet ta dijë se çka vjen prej Shpirtit Shenjt. Pra, si katolik mund të jemi të sigurt se Ripërtëritja është prej Zotit, duke u mbështetur në mësimet e Kishës. Do ta citoj artikullin, të cilin e kam lexuar në kohën e fundit në gazetën *New Covenant*.

Nuk kemi të drejtë të turpërohemi nga Shpirti Shenjt. Nuk kemi të drejtë t'i frenojmë dhuratat e Shpirtit Shenjt. Që t'i provosh dhuratat dhe të drejtosh me to është një gjë, dhe është diçka tjetër të turpërohesh dhe ta hedhësh poshtë rëndësinë e tyre. Të frenosh dhuratën e gjuhëve ose të ngulfatsh profecitë, do të thotë të kesh turp prej Shpirti Shenjt.

Artikulli vazhdon,

Mos u turpëro prej Shpirtit Shenjt dhe veprës së tij. Kudo që shfaqet pagëzimi me Shpirtin Shenjt, lutja në gjuhë të ndryshme, profecia, shërimi, liri nga shpirtrat e ndytë ose ndonjë dhuratë tjetër, mos të turpërohemi. Duhet ta vërejmë dhe ta pranojmë veprimin e Shpirtit Shenjt në jetën tonë.

Qysh në vitin 1973 kam dëgjuar një meshtar që ka qenë aktiv në Ripërtëritjen Karizmatike, i cili ka deklaruar kështu: "Nuk është e rëndësishme çka teologët ose njohësit e Shkrimit Shenjt thonë për Vap 2,4. Është fakt, se apostujt janë lutur në gjuhë të ndryshme, ashtu si i ka frymëzuar Shpirti Shenjt. Kanë pasur po atë përvojë, të cilën e kemi ne sot. A mundet dikush, i cili nuk e ka atë dhuratë, ta dijë se për çka është fjala? Si mund të dinë ata që nuk luten në gjuhë? Kjo deklaratë është mjaft e guximshme, por është e vërtetë.

Teologjia, në vetvete, është të menduarit në bazë të shpalljes dhe përvojës. Pikërisht për këtë Etërit e hershëm të Kishës kanë thënë se asnjë njeri nuk duhet të jetë teolog, për deri sa nuk bëhet i shenjtë, sepse deri në

ato çaste nuk e ka përvojën e Zotit në jetën e vet. Nëse nuk e ka përvojën e Zotit të gjallë, atëherë do të mendojë mbi Zotin vetëm në bazë të dëftimit pa përvojën personale.

Mjerisht, shumë laikë përjetojnë nënçmime nga ana e meshtarëve, të cilët japin deklarata si kjo: "O, e gjithë kjo është marri". Nëse jeni të sigurt dhe keni kurajë, gjithmonë mund të përgjigjeni kështu: "Atë, unë ndjek Kishën. Kisha ka vërtetuar se Ripërtëritja në Shpirt është vepër e Shpirtit Shenjt. A dëshiron ndoshta që t'i nënçmosh gjërat, pas të cilave qëndron Kisha?" Nganjëherë këta meshtarë mund të kenë të drejtë, nëse në ndonjë bashkësi janë të pranishme parregullsi të caktuara ose çrregullime. Ata atëherë i nënvizojnë vetëm ato çrregullime dhe thonë: "Mos më thoni se kjo është vepër e Shpirtit Shenjt". Njëri-tjetrin duhet ta përkujtojmë se flasim vetëm në mënyrë të përgjithshme për Ripërtëritjen në shpirt, jo për rastet specifike. Në disa bashkësi të lutjeve mund të ketë probleme të ndryshme, por problemet ekzistojnë në përgjithësi. Shumë njerëz e njohin teologjinë dhe e dinë se çka rekomandon Kisha, por megjithatë nuk i përmbahen kësaj. Kjo për mua është sikur të themi: "Ti Shpirti Shenjt, shko rrugës sate e unë do të shkoj rrugës sime".

Nëse Kisha e ka vërtetuar se Ripërtëritja Shpirtërore është vepër e Shpirtit Shenjt, dhe dikush e sulmon, mendoj se ai me të vërtetë e sulmon Kishën. Këto mendime më duken shumë të arsyeshme dhe ma shtojnë sigurinë. Unë e dëgjoj Kishën. Ky është argument i mirë për Ripërtëritjen dhe dhuratat shpirtërore, të cilat i pranojmë duke vepruar në Ripërtëritje. Do të citoj disa deklarata të rëndësishme që i kam mbledhur; ato flasin mbi mendimet tona të deritanishme në këtë libër:

Lutja në gjuhë nënkupton përvujtërinë dhe lirinë e brendshme në të cilën me vetëdije heqim dorë nga kontrolli i asaj që themi dhe lejojmë që gjuha të gufojë prej thellësisë së qenies sonë. Kjo kërkon që në sytë e njerëzve të dukemi dhe të flasim si të marrë; na liron nga dëshira për renome. Me këtë gjë, Ripërtëritja Karizmatike i mban larg vetes ata që kanë dëshirë të jenë atje për shkak të prestigjit. Nuk ka prestigj te ata që e posedojnë dhuratën e gjuhëve, së paku në bashkësinë time të besimtarëve (Robert Faricy, S. J.)

Gjuhët e ndryshme janë përvojë e vërtetë e fesë, ashtu si thotë Steve Clark:

Ajo që është edhe më e rëndësishme, gjuhët janë, zakonisht, dera që hap dimensionin karizmatik. Gjuhët ndërtojnë fenë personale në mënyrë konkrete. Ato besimtarit i japin përvojën e qartë se çka do të thotë, kur Shpirti Shenjt vepron në të – përvojën se si besimtari mund t'i lejojë Shpirtit Shenjt të ndërtojë në të diçka krejtësisht të re. Kushtimi i vetes dhuratës së gjuhëve është hapi i parë, shumë i rëndësishëm; duhet t'i ndihmojmë personit t'i dorëzohet kësaj përvoje, madje edhe nëse rrezikojmë që të na quajnë të pa baraspeshuar.

Dhurata është nën kontrollin e personit

Dhurata e gjuhës në të vërtetë nuk është gjuhë amnore dhe vjen prej frymëzimit të Shpirtit Shenjt, por është nën kontrollin e personit që lutet, kjo vlen edhe për dhuratën e profecisë: profecia është gjithmonë nën kontrollin e besimtarit, i cili profetizon. Lutja në gjuhë është gjithmonë nën kontrollin e atij që lutet; ai mund të fillojë dhe të ndalet së luturi sipas dëshirës së vet. Në atë lutje nuk përdoret mendja. Kjo më pëlqen, edhe për arsye se i përngjan lutjes kontemplative, lutjes së qetësisë, në të cilin mendja, gjithashtu, nuk merr pjesë.

Vullneti ynë mbetet i mbyllur në Zotin; zemra dhe mendja janë të fokusuar plotësisht në Jezu Krishtin, me të cilën hyjmë në bashkësi të ngushtë. Mendja jonë ende mund të “bredhë”, por kjo lutje është, para së gjithash, vepër e zemrës.

Gjithashtu, lutja e gjuhëve është vepër e vullnetit tonë, si lutja e rruzares. Për deri sa ta lutësh rruzaren, zemrën dhe mendjen tënde i lartëson tek Zoti; papritmas ndodh që mendimet tua shkojnë në treg dhe krahasojnë çmimet e mollëve dhe portokajve, por vullnesa jote është fokusuar në Jezu Krishtin dhe Zojën e Bekuar. Mendimet mund të largohen dhe kjo nuk është gjë shumë e keqe. Kur të ndodh kjo, vetëdijesohu për mungesën e përqendrimit tënd dhe mendimet tua ktheji kah Zoti. Në fillim hasim në vështirësi, sepse jemi të “programuar” të mendojmë; se lutemi vetëm atëherë kur i lartësojmë mendimet dhe zemrat tona tek Zoti. Imagjinoni një person para vdekjes, i cili ka mundësi vetëm të përsërisë emrin e Jezusit. Kjo është lutje e thjeshtë dhe e mrekullueshme, në të cilën nuk përdoret mendja.

Domethënë, lutja në gjuhë të ndryshme është dhuratë e përhershme. Duhet ta përdorim sipas vullnetit të lirë, me urti dhe në mënyrë racionale. Të gjitha dhuratat si dhe mbarë jeta e krishterë duhet të jetë e udhëhequr nga urtia.

Para disa vjetësh kam qenë i pranishëm në liturgjinë solemne të së Enjtes së madhe bashkë me 200 vëllezër të mi meshtarë. Pas kushtimit të bukës dhe verës, dikush në fund të kishës filloi të lutet me zë, në gjuhë të ndryshme. Nuk kam mundur të besoj. Dëgjohej në mbarë kishën. Ky ka qenë shembull klasik se si nuk është vepruar me urti. Natyrisht, të gjithë në kishë kanë qenë të befasuar, “u shtanguan”. Do ta kisha pyetur atë person: “A vepron në Shpirtin Shenjt apo bën diçka tënden?”. Të kërkojmë urtinë dhe të veprojmë në urti. Mos të lutemi me zë gjatë meshës në kishë.

Të gjitha dhuratat duhet të përdoren me urti. Më mirë të themi: mbarë jeta jonë e krishterë, duhet të pasqyrojë urtinë. “O Zot, çka dëshiron të bëj. Dëshiroj të bëj vetëm atë që Ti dëshiron.” Në shërbimin tonë mos të tentojmë

të bëjmë vetëm gjëra të mira, por të mundohemi të bëjmë atë çka Zoti do që të bëjmë.

Thomas Green, S. J., në librin e tij Terri në treg flet për këtë dallim:

Ne mund të punojmë për Zotin; mund të zgjedhim se çka dëshirojmë t'i japim, çka dëshirojmë t'i pëlqejë Atij, çka mendojmë ne se Ai ka nevojë dhe për çka ka dëshirë. Ose – mund të pyesim Zotin për çka Ai ka dëshirë dhe të bëjmë atë çka është vullneti i Tij – ‘të bëjmë veprën e Tij’ – sado që kjo nuk është tërheqëse dhe duket e mërzitshme për ne”.

Ipeshkvi McKinny gjithashtu ka thënë diçka të rëndësishme mbi gjuhët dhe shërbimin:

Nëpërmes dhuratës së gjuhës jam bërë shumë më i ndjeshëm në iniciativat e Zotit. Lutja është shumë më e pasur, kur plotësisht i dorëzohem Shpirtit. Predikimi është më i fortë kur jam i varur nga fuqia e Shpirtit Shenjt. Shërbimi është më i frytshëm kur e thërras Shpirtin Shenjt. Ndërtimi i bashkësisë sonë është më i mirë, kur jam i ndjeshëm në Shpirtit Shenjt.

Këto fjalë janë shembuj të shkëlqyeshëm të urtisë në Shpirtin Shenjt. Të kërkojmë urtinë që vjen nga Shpirti Shenjt, gjithmonë duke ditur se dhuratat janë nën kontrollin e vullnetit tonë.

T’ia japim veten dhuratës së gjuhëve

Kur jam së bashku me të pranishmit që e dëshirojnë dhuratën e gjuhëve, i lus që ta formojnë rrethin, duke u mbajtur dorë për dore. Është shumë me rëndësi që t’i bind se këtë e kam bërë shumë herë. Ata duhet të besojnë se Zoti e sheh vullnetin e tyre të mirë, se Ai do t’iu japë fuqi që t’i jepen kësaj përvoje, sepse Shpirti Shenjt dëshiron, që, nëpërmes të dhuratës së gjuhëve të ndryshme, t’i forcojë lutjet dhe jetën e tyre të lutjes.

Kjo metodë është treguar efikase me qindra herë. Vetëm është e nevojshme të bëhen “si fëmijë të vegjël”.

Nga përvoja e dimë gjithashtu se 50% e atyre që hyjnë në rreth, e kanë dhuratën, por nuk e besojnë këtë. Duke vepruar në dhuratën e dallimit të shpirtave, ne i bindim se ata vërtet luten në gjuhë të ndryshme. Nëpër dhuratën e dallimit të shpirtave, ne ndjejmë ndikime pozitive derisa ata luten në gjuhë të ndryshme. Shpesh ndiejmë se ata duhet ta përballojnë ndjenjën e padenjesisë, fajësisë dhe frikës. Në përgjithësi, katolikët turpërohen nga gjestet religjioze publike; po ashtu edhe nga dhuratat shpirtërore.

Çka është e nevojshme që të kemi mundësi ta japim veten në dorë të dhuratës së gjuhëve të ndryshme? Në librin *Riding the Wind*, Ati George Montague jep përgjigje të shkëlqyeshme:

Ai që dëshiron ta mësojë notin, duhet në një mënyrë të lirohet. Nuk mundet pandërprerë “ta rrahë” ujin. Ai patjetër duhet të rrezikojë nëse dëshiron të zbulojë se si do ta mbajë dhe bart uji. Gjithashtu unë duhet të kthehem kah Zoti në një mënyrë të re. Duhet të drejtohem kah Ai nëpër ujin

e fesë sime, ashtu si ka bërë Pjetri (Mt 14,22-23); kjo dmth. se duhet ta braktis sigurinë e luhatshme – ose pronësinë, urrejtjen ose çka do që e mbaj si mjet të dëshirës sime më shumë se Zotin.

Madje, edhe kur fillojmë të lutemi në fe, do të vijë tundimi që ta imitojmë dikë, që vetë të formojmë disa fjalë ose që ta luajmë rolin e të marrit. Rreth kësaj do të thosha: shumë prej nesh luajnë rolin e të marrit në festa të ndryshme, sidomos në festën e Vitin të Ri, kur mbajmë republika dhe kapela qesharake dhe lëshojmë zëra si fëmijë të habitur pas lojës. A kemi frikë të bëhemi të marrë për Zotin? Për sa i përket vërejtjes për imitim, dëshiroj që ta nxis këdo qoftë, që të provojë për të imituar 5 minuta lutjen e gjuhëve të ndryshme. Dhurata e gjuhëve nuk mund të trillohet, sepse në shpirt do të ndjehej si diçka absurde. Kur dëgjojmë lutjen e vërtetë në gjuhë, ajo është aq qetësuese. Nëpër dhuratën e dallimit të shpirtave mund ta njohim a është me të vërtetë fjala për dhuratën e gjuhëve. Kjo është dhuratë që në mënyrë intuitive zbulon veprimin e Shpirtit Shenjt.

Dëshiroj të theksoj edhe një gjë të rëndësishme; ky është parimi i refleksionit që ekziston në teologji. Meshtarët e dinë se për çka është fjala. Çdo veprim është i caktuar me qëllimin. Nëse ti ke qëllim për ta lavdëruar Zotin, madje edhe duke trilluar disa rrokje, ti lutesh në gjuhë, edhe ashtu lavdëron Zotin. Nëse qëllimi yt është për ta lavdëruar Zotin dhe në gjuhë të ndryshme imiton dikë afër vetes, përsëri lavdëron Zotin. Nëse qëllimi yt është për ta lavdëruar Zotin edhe kur ti luan rolin e të marrit, edhe ashtu e lavdëron Zotin.

Zoti nuk shikon ashtu si shikon njeriu: njeriu sheh çka duket përjashta, kurse Zoti vëren zemrën. (1 Sam 16.7).

Atë që pranon në fillim, mund të jetë vetëm një rrokje. Kjo mjafton. Fillo me atë rrokje. Shumë prej jush e dinë se si veprojnë pompat e ujit. Kur fillojmë për ta shtypur, uji akoma nuk del. Pas pak kohe uji rrjedh. Ajo që dëshirojmë për të bërë, është pikërisht kjo. Dëshirojmë t'ju ndihmojmë që "uji i gjallë" që vjen nga Zoti, të fillojë për të buruar nga brendësia juaj. Në fund do të jeni të vërsuar me këtë ujë të gjallë. Ndoshta është vetëm një rrokje sot, por do të vijë shumë e më shumë dhe pas ca kohe dhurata jote do të jetë shumë e begatshme.

Nuk guxojmë të harrojmë se në fillim të gjithë e kanë kaluar procesin e njëjtë. Gjuha jote e lutjes zhvillohet dhe në fund bëhet krejtësisht e qartë. Gjuha e lutjes mund të ndërrohet me kohë, ashtu si do të kalosh nëpër nivele të ndryshme të rritjes shpirtërore.

T'i kthehemi përsëri metodës dhe situatës reale. Unë do t'ju lutesha që të më imitoni në lutjen e gjuhëve të ndryshme. Me këtë dëshiroj që të tërheq vëmendjen tuaj nga njerëzit përreth jush, që të mos e ktheni mendjen se çka të pranishmit mendojnë për ju. Nëse përqendroheni vetëm në një rrokje, "pompa" do të fillojë të punojë. Përkujtojeni makinat e vjetra, të cilat ndizeshin me "çikrik". Njeriu rrotullon e rrotullon, deri sa ndezja e brendshme nuk e

lëviz motorin; pastaj motori punon vetë. Në mënyrë të ngjashme Shpirti Shenjt vepron nga thellësia e shpirtit tuaj dhe nëpër aparatit tonë të foljes në fillojmë të lutemi në gjuhë të ndryshme.

Kjo metodë është treguar efektive në shumë shtete ku kam qenë, madje edhe nëpërmes të përkthyesve. Përkujtohu se nëse je pagëzuar me Shpirtin Shenjt, atëherë ti e ke këtë dhuratë. Nuk të mësoj si do të lutesh në gjuhë të ndryshme, po të mësoj se si t'ia liros veten ujit të gjallë, i cili gjendet brenda teje. Dëshiroj ta jap ndihmën time, që ky ujë të rrjedhë prej teje. Lutja në gjuhë të ndryshme është pjesa më normale e jetës së krishterë. Kur t'ia kushtosh veten kësaj përvoje dhe të vazhdosh të lutesh në gjuhë, do të zbulosh se kjo dhuratë të bën të ndjeshëm për dhuratat tjera shpirtërore, ashtu si thotë atë Vincent Valsh:

Lutjet e gjuhëve kurrë nuk duhet për t'i braktisur. Ato janë fillim i veprimit të Shpirtit Shenjt, si dhe përgatitje për veprimin e Tij shumë më të thellë dhe më të fortë. Kudo që është Shpirti Shenjt, atje janë edhe lutjet në gjuhë të ndryshme. Kjo është dhuratë e sigurisë: na ndihmon të jemi krejtësisht të bindur, se veprojmë në Shpirtin Shenjt që e ka dërguar Jezu Krishti.

Gjuhët janë derë për atë veprimtari (të Shpirtit Shenjt) Dera nuk është shtëpi, por nëpër të hyhet normalisht. Pra, fillimi dhe hyrja logjike në shtëpinë, të cilën Zoti dëshiron ta ndërtojë, është lutja në gjuhët e ndryshme (kjo vlen edhe për individin dhe për bashkësinë e lutjes).

Kur lutesh në gjuhë, mbushesh me fuqi të madhe dhe me ndjeshmëri; atëherë je i hapur edhe për të gjitha dhuratat tjera. Gjuhët janë bekim i madh i Zotit, sepse paraqesin atë mënyrë të re, në të cilën njeriu mund ta lavdërojë Zotin e vet. Ato na ndihmojnë ta plotësojmë urdhrin e parë të Zotit, i cili na thotë: të "adhurojmë Zotin tonë". Dhurata e gjuhëve është shumë e rëndësishme. Unë shpesh e theksoj, se vetëm nëpërmes dhuratave të shpirtit, njeriu mundet plotësisht t'i dorëzohet Shpirtit Shenjt. Me fjalë të tjera, kur t'i dorëzohesh dhuratës së gjuhëve të ndryshme, ti, mendjen, vullnetin dhe aparatit folës ia dhuron Zotit duke thënë: "O Zot, ja ku jam, të dorëzohem në dorën tënde, më përdor". Shpesh kjo gjë është e vështirë, sepse shumë njerëz, në nënvetëdije, hamenden t'i dorëzohen krejtësisht Zotit.

Në fund, dëshiroj t'ju jap kurajë që t'i dorëzoheni plotësisht Zotit. Lutem për secilin, posaçërisht që te ai, të lirohet dhurata e gjuhëve të ndryshme. Gjatë kësaj kohe edhe unë vetë lutem në gjuhë. Ata më dëgjojnë dhe provojnë të më imitojnë. Mos harro, se unë ju ndihmoj vetëm që të fillojnë, vetëm filloj që ta shtyp "pompën". Së shpejti do të dalin rrokjet e tyre dhe ata do të luten ashtu si i frymëzon Zoti. Ashtu sikurse fëmija i vogël imiton prindërit e vet, në nivelin shpirtëror mësojmë si të lutemi në dhuratën e gjuhëve.

Është shumë e rëndësishme që të fillojmë dhe të themi diçka. Të ngremë mjekrën, ashtu si bëjmë kur përgatitemi për të kënduar, mund të na ndihmojë gjithashtu. Në këtë mënyrë tregojmë dëshirën që të themi diçka. Atëherë hape gojën dhe lëshoji fjalët që të rrjedhin, madje edhe nëse është imitim i personit afër teje ose shprehja e emrit Jezu ose Abba. Do të vijë koha kur në vend të këtyre fjalëve të njohura do të rrjedhë gjuha. Ndoshta vetëm një rrokje – edhe kjo është shumë mirë. Kjo është për fillim – mbajeni atë rrokje. Ndoshta do të të duket e çuditshme, por e çuditshme është vetëm për ne. Zoti na dëgjon dhe është i kënaqur se jemi të gatshëm të jemi si fëmijë të vegjël.

Lutja:

O Zot, nuk kuptoj çka flas, por besoj se kjo vjen nga Shpirti Shenjt. Besoj se Shpirtit Shenjt më frymëzon; do të lutem edhe më tutje pa marrë parasysh se si do të ndjehem. Në këtë moment ndoshta do të kisha bërë diçka tjetër më me dëshirë, por, këtu jam sepse dëshiroj që Të të lavdëroj dhe Të të adhuroj. Më ndihmo që Ty të dorëzohem plotësisht. Eja, o Zot Jezu, eja.

Të gjithë u mbushën me Shpirtin Shenjt dhe filluan të flasin në gjuhë të ndryshme, ashtu si Shpirtit Shenjt i shndriste të shpreheshin. (Vap 2,4).

Për ata që kanë dëshirë për t'u lutur në gjuhë të ndryshme deri sa lexojnë këtë libër, rekomandoj:

Mbyllu në dhomën tënde ose në një vend tjetër ku mund të jesh vetëm, gjunjëzohu dhe lute Zotit që të dhurojë dhuratën e lutjes në gjuhë. Atëherë me fe në Të dhe në mirësinë e tij, shikoje me sytë e fesë. Hape gojën dhe fillo për t'u lutur ose për të kënduar rrokjet, të cilat, në shikim të parë, duket se nuk kanë kuptim, si fëmija i vogël që ende nuk ka filluar të flasë. Lejoji që të rrjedhë. Kjo është dhurata e gjuhës. Mungesa e komoditetit që ndien është krenaria jote e lënduar; këtë do ta përballosh. Falëndero Zotin për dhuratën e re të kontemplacionit, të cilën ta ka dhuruar.

Përmbledhja Dhurata e gjuhëve

1. Dhurata e gjuhëve të ndryshme është në planin e Zotit, si na është zbuluar në Shkrimet. Lutuni në bashkim me Shpirtin Shenjt, me çdo uratë e lutje e në çdo rast. (Ef 6, 18).

2. Kjo dhuratë është për të gjithë. Shenjat që do t'i përcjellin ata që do të besojnë, janë këto: në emër tim do t'i dëbojnë djajtë, do të flasin gjuhë të reja...(Mk 16,17)

3. Dhurata e gjuhës është e thjeshtë, por jo e lehtë. Kur dëgjuan, u pagëzuan në Emër të Jezusit, e kur Pali i vuri duart mbi ta, në ta zbriti Shpirti Shenjt dhe filluan të flasin në gjuhë të ndryshme dhe të profetizojnë.(Vap 19,6)

4. Zërin duhet t'ia japësh Zotit. Të pagëzohesh me Shpirtin Shenjt, do të thotë t'ia lëshosh Shpirtin tënd në dorë të Zotit; dhurata e gjuhës do të thotë t'ia kushtosh aparatit tënd të folurit Zotit; dhurata e profecisë do të thotë t'ia kushtosh mendjen tënde Zotit; pushimi në Shpirt do të thotë t'ia japësh trupin tënd Zotit. Faleminderit Hyjit, unë flas në gjuhë të huaja më tepër se ju të gjithë, porse në një mbledhje, më tepër dëshiroj të them vetëm pesë fjalë që merren vesh për mësim të të tjerëve, se sa dhjetë mijë fjalë në gjuhë të huaja (Kor 14,18-19)

5. Ky është lloji i lutjes kontemplative: lutje e qetësisë; lutje e zemrës. Sepse, ai që flet gjuhë të huaj, flet me Hyjin e jo me njerëz: askush nuk e merr vesh, sepse me anë të Shpirtit flet gjëra të fshehura.(1 Kor 14,2)

6. Kjo lutje është e fuqishme. Kështu, pra, edhe Shpirti Shenjt na ndihmon kundruall paaftësisë sonë, sepse ne nuk dimë as çka të kërkojmë me lutje si duhet, por vetë Shpirti Shenjt lutet për ne me ofshama të patregueshme. E Ai që i njeh zemrat, e di dëshirën e Shpirtit Shenjt - se ai lutet për besimtarët ashtu si do Hyji. (Rom 8,26-27)

7. Sjell fryt të mirë. Secili merr dhuratë të veçantë të zbulesës së Shpirtit Shenjt për të mirën e përbashkët. Dhe përnjëmend, Shpirti Shenjt i jep njërit fjalën e urtisë. Kurse i njëjti Shpirt Shenjt një tjetri i jep fjalën e dijes, po i njëjti Shpirt Shenjt një tjetri i jep fenë, një tjetri prapë, i njëjti Shpirt Shenjt, i jep dhuratën e shërimit, një tjetri pushtetin për të bërë mrekulli, një tjetri profecinë, një tjetri aftësinë që të dallojë shpirtrat, një tjetri zotësinë e gjuhëve të ndryshme, një tjetri shtjellimin e gjuhëve. (1 Kor 12, 7-11)

8. Sjell revolucionin në lutje dhe jetën tënde. Ai që flet në gjuhë të huaj edukon veten, kurse ai që profetizon, edukon bashkësinë. Dëshiroj që të gjithë ju të flisni në gjuhë të ndryshme, por më tepër dëshiroj të profetizoni, sepse më i madh është ai që profetizon se ai që flet në gjuhë të ndryshme, përveç se në shtjelloftë për edukimin e Kishës. (Kor 14,4-6)

9. Të bën të ndjeshëm në nxitjen dhe veprimin e Shpirtit Shenjt. Të bën të hapur për dhuratat tjera shpirtërore. Të hap që të kesh mundësi për të

pranuar mrekulli. Prandaj, o vëllezër, dëshironi dhuratën e profecisë, por mos pengoni të flasin në gjuhë të ndryshme, e gjithçka le të bëhet në mënyrë të ndershme e rregullisht. (1 Kor 14,39-40)

10. Dhurata e gjuhëve të ndryshme duhet kurajuar tek të gjithë. Të gjithë u mbushën me Shpirtit Shenjt dhe filluan të flasin në gjuhë të ndryshme, ashtu si Shpirti Shenjt i shndriste të shpreheshin. (Vap 2,4)

11. Duhet më shumë mësim cilësor nga ana e udhëheqësit. Kështu, Hyji në Kishë disa i caktoi: më parë apostujt, së dyti profetët, së treti mësuesit; pastaj vjen dhurata e mrekullive, pastaj ajo e shërimit, kujdesimit, e drejtimit shpirtëror, dhurata e gjuhëve të ndryshme. (Kor 12,28)

12. Duhet të krijohet atmosferë festive. Në ligj është shkruar: 'Unë do t'i flas këtij populli – thotë Zoti në gjuhë të huaja e me buzë të huaja dhe as ashtu nuk do të më dëgjojnë,' këndej gjuhët e huaja nuk janë shenjë për besimtarët, por janë shenjë për ata që nuk besojnë, e përkundrazi profecia është shenjë për besimtarët e jo për ata që nuk besojnë. (Kor 14,21-22)

13. Gjuhët janë mënyra më e mirë për të lavdëruar Zotin. Sepse i dëgjuan duke folur gjuhë të ndryshme e duke madhëruar Hyjin. (Vap 10,46)

14. Gjuhët forcojnë shërbesën e dikujt. "Judenj e proselitë, kretas e arabë, të gjithë ne po i dëgjojmë duke shpallur veprat e madhërueshme të Hyjit..." (Vap 2,11)

15. Kjo është lutje e fuqishme dhe efektive e ndërmjetësimit."... Dhurata e gjuhës, në vete, është dhuratë e lutjes kontemplative. Të pranosh dhuratën e gjuhëve të ndryshme, dmth të pranosh dhuratën e kontemplacionit". (Robert Faricy,S.J.)

16. Dhurata e gjuhës është rritje e rëndësishme personale shpirtërore. Po t'i flisja gjuhët e njerëzve e të engjëjve, por të mos kisha dashuri, do të isha porsì bronzi që kumbon. (Kor 13,1)

17. Është e rëndësishme si lutje për shërim të brendshëm. "Efekti i vërtetë i gjuhëve të ndryshme nuk është vetëm në shprehjen e jashtme të fjalëve, por veprimi i thellë i Shpirtit Shenjt në thellësinë e atyre që luten". (Msgr Vincent M. Walsh)

Dëshmi personale

Kam qenë vetëm një muaj në Ripërtëritje Karizmatike, kur kam pranuar pagëzimin me Shpirtin Shenjt dhe dhuratën e gjuhës në të njëjtën kohë. Thjesht, kam kërkuar; besoj se kam qenë i hapur, kur kam hyrë në përvojën e dhuratës së gjuhës pa farë vështirësie. Këtë përvojë nuk mund ta shpjegoj ndryshe, por sikur fluturoja.

Prej atëherë kjo dhuratë më ka ndihmuar në mënyra të shumta. Për shembull, kur më përfshin ankthi, shqetësimi, frika, depresioni, zhgënjimi, lutem në gjuhë të ndryshme, që më ndihmon të dal prej atyre situatave. Ndiej se nëpër dhuratën e gjuhëve kam të njëjtat mendime sikur Jezusi, sikur jam në vullnetin që ai ka për jetën time.

Myrtis

Kur për të parën herë kam dëgjuar për lutjen në gjuhë të ndryshme para tetë vjetësh, më dukej si diçka e njohur. Në të njëjtin moment e kam ditur se e dëshiroj shumë këtë dhuratë. Pas tri javësh, gjatë lutjes në shtëpi tek një miku im, i kam lutur të pranishmit të luten që unë të pranoj dhuratën e gjuhës. Janë lutur por dukej sikur asgjë nuk ka ndodhur; kam qenë e dëshpëruar. Gjatë rrugës për në shtëpi e bindja veten se e kam atë dhuratë. Atëherë edhe kam filluar të lutem në gjuhë. Dhe jo vetëm kaq - kam kuptuar se e kam këtë dhuratë prej moshës dymbëdhjetë vjeçare. Gjatë larjes gjithmonë duke kënduar lëshoja zëra dhe rrokje të çuditshme. Unë jam njëra prej atyre që këndojnë në banjë – mirëpo atje këndoja në ato gjuhë të çuditshme.

Dhuratën e gjuhës e shfrytëzoj që të rregullohem dhe qetësohem para lutjes dhe që t'u ndihmoj të tjerëve që të afrohen tek Zoti deri sa lutem për ta.

Priscilla

Nuk më kujtohet kur jam lutur të parën herë në gjuhë të ndryshme. Kjo ka ndodhur pak kohë pasi që kam qenë pagëzuar me Shpirtin Shenjt. Thjeshtë, ka ndodhur.

Bob

Jam Ripërtërirë Shpirtërisht që nga viti 1970, dhe ka kaluar shumë kohë para se të hyjë në këtë dhuratë. Në takimet e lutjes i bija kitarës dhe nganjëherë, pasi muzika qetësohej, dëgjoja diçka sikur koret engjëllore – njerëzit luteshin në gjuhë. Këta zëra ishin të çuditshëm, por të bukur – edhe unë dëshiroja të lutesha ashtu.

Kjo nuk ndodhi deri më 1977, kur një udhëheqës i bashkësisë së lutjes më tha se duhet të bëhem si fëmijë i vogël dhe çdo natë të përsëris fjalët Abba ose Jezu. Më tha se kjo do të ndodhë nëse do të kem fenë e fëmijës.

Ashtu edhe u bë – së pari më erdhi një rrokje, më vonë fjala, pastaj e tërë fjalia.

Unë personalisht ngadalë kam hyrë në këtë dhuratë, por për mua ka qenë problem i madh madje edhe për t'i lartësuar duart në takimin e lutjes. Dhurata e gjuhës, vërtet, shumë e ka pasuruar jetën time.

Daisy

Më ka ndodhur kjo në takimin e lutjes - një motër më nxori nga grupi prej dyzet personash dhe më tha se dëshiron të më ndihmojë që ta pranoj dhuratën e gjuhës. Kemi shkuar në një dhomë tjetër ku më tha që të provoj me rrokjet e alfabetit: AB, AC, AD, AE. I kam përsëritur ato rrokje por asgjë nuk ndodhi. Kjo, me të vërtetë më ka zhgënjyer. Më tha që të filloj dhe pas njëzet minutash jam lutur në gjuhë të ndryshme.

Mark

Disa muaj kam qenë në Ripërtëritje Shpirtërore, kur më kanë thirrur për të frekuentuar seminarin me emrin Jeta në Shpirtin Shenjt. Në seminar kemi mësuar për dhuratat e shumta të Shpirtit Shenjt, natyrisht se njëra prej tyre ka qenë edhe dhurata e gjuhëve. Aq shumë e dëshiroja atë dhuratë, sepse dikush më ka thënë se djalli e urren lutjen në gjuhë të ndryshme. Nuk e kam fituar atë dhuratë, edhe pse të tjerët janë lutur për mua. Më kanë trimëruar që të ushtroj duke i thënë shkronjat e alfabetit – Zoti e ka bekuar këmbënguljen time dhe së shpejti jam lutur në gjuhë të ndryshme. Kjo për mua ka qenë bekim i madh. Në fillim më dukej pak e çuditshme, por këtë shpejt e përballova.

Shumë kohë kaloj në shtëpi dhe lutjen në gjuhë e shfrytëzoj për të ngritur jetën shpirtërore dhe për të ndërtuar veten. Deri sa punoj nëpër shtëpi, këndoj në gjuhë të ndryshme. – kjo vërtet më lart]ëson.

Yvonne

Pagëzimin në Shpirt e kam përjetuar më 1979, por dhuratën e gjuhëve nuk e kam pranuar deri më 13 qershor 1980 (një javë para ditëlindjes sime). Kam qenë në seminarin e lavdërimit në kishën e Shën Pjetrit në New Orleans. Ati DeGrandis ka qenë udhëheqës. Isha ulur pranë Benit, mikut tim të mirë. Papritmas, derisa këndonim, përjetova sikur po dilja prej trupit tim, po largohesha prej kishës dhe shkoja diku lart, ku kam mundur të dëgjoj muzikë të mrekullueshme. Nuk e di sa ka zgjatur kjo përvojë, por kur jam "kthyer", jam lutur në gjuhë të ndryshme.

Të nesërmen në mëngjes, duke shkuar në punë, nuk kam mundur ta ndal këngën. Këndoja në gjuhë; kanë qenë këngë falënderimi Zotit. Kam kënduar edhe në zyrë. E thirra të dashurën time dhe e luta që të takohemi për pak kohë – kisha dëshirë t'i thosha se çka ka ndodhur. Më vonë më ka thënë,

posa më kishte parë, menjëherë e ka ditur nga ndriçimi i fytyrës sime, se çka ka ndodhur.

Pat

Dhuratën e gjuhëve e kam pranuar menjëherë. Pas pagëzimit me Shpirtin Shenjt janë lutur për mua dhe në të njëjtin moment e kam pranuar dhuratën e gjuhëve të ndryshme. Jam lutur tërë natën. Nuk mund të ndalesha; dhe as që e dëshiroja këtë gjë. Ndjehesha i lehtë, i tejdukshëm, dhe aq i lumtur.

Në gjuhë lutem zakonisht në mbrëmje, para së të shkoj për të fjetur. Kjo më ndihmon për të fjetur mirë. Gjithashtu lutem në gjuhë, kur ndiej thatësi në lutjen konvencionale.

Vilbur

Së pari kam lexuar librin *Pentakostalët katolikë* të Kevin dhe Dorothy Ranaghan. Çdo gjë që kanë besuar ata, edhe unë e kam besuar – përveç lutjes në gjuhë të ndryshme. Vërtet, nuk më ka pëlqyer – menjëherë shqetësohesha posa mendoja për të. Pas pak kohe mora pjesë në seminarin Jeta në Shpirtin Shenjt, ku përjetova pagëzimin me Shpirtin Shenjt, por ende nuk isha e hapur për dhuratën e gjuhëve. Pas disa javësh fillova që të lutem për këtë dhuratë. (Burri im e ka pasur. Ai të gjitha gjërat i bën në shpejtësi). Së shpejti fillova të besoj se pagëzimi im me Shpirtin Shenjt duhet të jetë i përcjellur me dhuratën e gjuhëve të ndryshme, përndryshe Zoti do të më lër në gjysmë të rrugës.

Si sot më kujtohet dita, kur, duke pastruar pas kanapesë, gjeta një lodër. Bija ime Monika, duke parë lodrën, tha në mënyrë të vendosur: "Kjo është lodra ime. Ma jep. Kjo është imja". "Natyrisht" i thashë me butësi, "kjo është e jotja". Në atë moment kam përjetuar një shndritje – e kuptova se Zoti më flet mua në mënyrë identike; vetëm rolet janë ndërruar. Dhurata e Gjuhës ka qenë imja dhe Zoti ka dashur ta kem. Pas pak kohe e kam pasur përvojën e dhuratës së gjuhës në Meshë, pas kungimit.

Sot, kur lutem në gjuhë, mendoj për gjuhët e shumta të popujve, të cilët gjatë shekujve nuk e kanë njohur Zotin, dhe nuk e kanë lavdëruar. Tani ne e lavdërojmë Zotin në të gjitha ato gjuhë.

Nancy

Pas pjesës së parë të seminarit Jeta në Shpirt, disa flisnin në gjuhë të ndryshme, nuk isha krejtësisht e sigurt për atë që dëgjoja, por më dukej se disa e flisnin shkëlqyeshëm kinezishten.

Në të njëjtit tubim të lutjes disa i shtrinë duart mbi mua dhe u lutën për problemet që i kisha me qafën. As që kuptoja se jam pagëzuar me Shpirtin

Shenjt. Të nesërmen në mëngjes, gjatë larjes së enëve, këndoja - tingëllonte si kinezishte. Vërtetë kënaqesha duke kënduar në atë gjuhë të re. Mendoja: "Po kjo nuk qenka fare vështirë. Këtë e kam bërë gjatë tërë jetës sime". As që e lidhja këtë me pagëzimin me Shpirtin Shenjt. Mendoja se kjo është vetëm aftësi për lutje që e kanë edhe të tjerët. Megjithatë, vëreja se gjatë lutjes në mendje më vinë disa njerëz.

Javën e ardhshme, kur kam shkuar në takimin e lutjes – pa e ditur – fillova të këndoj në këtë gjuhë për të cilin mendoja se po e imagjinoja vetë. Mirëpo, njerëzit më kanë thënë: "Joann, Ti lutesh në dhuratën e gjuhës".

Si do që të jetë, unë këtë dhuratë e kam pranuar afër lavamanit në kuzhinë.

Joann

Pasi që mora pjesë në Ripërtëritjen Shpirtërore në një fundjavë, më kujtohet se shumica gjatë asaj kohë filluan për t'u lutur në gjuhë të ndryshme. Unë provoja, por asgjë nuk ndodhte. Për mua janë lutur shpesh që ta pranoj dhuratën e gjuhës, por kot.

Më në fund shkova në një takim ku punohej për të hyrë në përvojën e dhuratës së gjuhës. Udhëheqësi e shpjegoi se këtë dhuratë e kontrollojmë dhe se në fillim është më mirë të lavdërojmë Zotin në gjuhën angleze. Pasi që e bëmë këtë, na tha që të vazhdojmë edhe me tutje, por jo në gjuhën angleze. Kur provova ashtu si na udhëhiqte, brenda meje u lirua dhurata e gjuhës dhe lirisht fillova ta lëvdoj Zotin me Zërin tim. Amen.

Rob

Mbasi disa ditë u lutën për mua që ta pranoja pagëzimin me Shpirtin Shenjt, deri sa këndoja dhe lavdëroja Zotin gjatë punëve shtëpiake, u vetëdijesova se disa rrokje ose fjalë të çuditshme paraqiten dhe përsëriten pandërprerë. Vinin nga një qoshe e mendjes sime, qetë dhe në mënyrë diskrete. Edhe pse disa shokë të mi më kishin thënë se mund të pres gjuhë të re në lutje, tani e kisha bindur veten se këtë po e pjell mendja ime, pasi që kisha dëgjuar disa kasete. Sa më kujtohet Brennan Manning flet si fëmijët fillojnë të flasin ab-ba, Abba. Pikërisht këtë fjalë Ati im i dashur ma ka vënë më mendje për të forcuar fenë time. Dhe unë isha si fëmijë i vogël dhe mësoja që të flisja këtë gjuhë të re, duke përsëritur pa numër këtë fjalë të vetme. Pas një apo dy ditë u duk fjala e re, pastaj disa; pas një jave flisja fjali. Po të mos e kisha dëgjuar në kasetë këtë fjalë të huaj, ndoshta do të kisha refuzuar këtë dhuratë të shkëlqyeshme të cilën ma dhuron "Ati im".

Caro M.

Gjatë pjesëmarrjes në seminarin Jeta në Shpirt, udhëheqësit na kanë thënë se do t'i pranojmë dhuratat nga Zoti. Pas ligjëratës i kam thënë njërit nga udhëheqësit, se unë, edhe pse nuk i refuzoj dhuratat, më shumë dëshiroj për ta pranuar paqen – paqen e thellë në zemër dhe në mendje për të cilën kam pasur shumë nevojë në këtë fazë të jetës sime. I kam shpjeguar se mendimi për dhuratën e gjuhës nuk më vërshon me shqetësim, sepse paqja e thellë është ajo që në këtë moment kërkoj. Me të dëshiroj të kthehem në shtëpi pas kësaj fundjave.

Dy ditë më vonë isha i ulur pranë tavolinës sime të punës dhe kënga “Kurrë nuk do të harroj” më erdhi në kokë me intensitet aq të madh, sa që filloi të më pengojë. Nuk mund të punoja. Ndjeja lumturi të qëndroja ulur, duke dëgjuar këtë këngë në kokë. Kur provova ta këndoja këtë melodi, në mendimet e mia, tingëllonte si të këndoja në latinishte. E tërë kënga u bë sikur të këndohej në latinishte. Shpejt e thirra mikun, i cili ka mësuar latinisht në shkollë dhe e pyeta për disa fjalë, të cilat më kanë ardhur në mendje. Ai më bindi se këto fjalë nuk janë latine. Mirëpo, paqja dhe gëzimi që më kishte përmbushur, derisa këndoja, në kokën time (vinin edhe fjalë të tjera) vazhdoi që të vërshonte qenien time.

Pas pak kohe, përvojën time ia tregova një mikeshës sime, e cila e ka studiuar latinishten dhe ishte e kyçur në Ripërtëritjen Shpirtërore. Ajo më shpjegoi se unë, në të vërtetë, e kisha pranuar dhuratën e gjuhës.

Pas disa ditësh përsëri shkova në seminarin Jeta në Shpirtin Shenjt. Ende qëndroja pezull përmbi tokë, i mbushur me paqen dhe me gëzimin, të cilin e kam dëshiruar me vite. Isha shumë i lumtur, kur udhëheqësve dhe të gjithë të pranishmëve kam mundur t'u tregoj se bashkë me paqen dhe gëzimin e thellë, kam pranuar edhe dhuratën e gjuhëve të ndryshme.

Lou M.

Qysh se isha në shkollë kam dëgjuar për Ripërtëritjen Shpirtërore dhe për njerëzit që luten në gjuhë të ndryshme. Kjo më frikësonte – frikësohesha se do të më përfshinte ndonjë fuqi dhe unë do të filloja të flas në gjuhë të ndryshme. E kam lutur Zotin që, nëse më dëshiron në Ripërtëritje, le të më qesë në zemër dëshirën e madhe për dhuratën e gjuhëve.

Pas një muaji, një mik më thirri në lutje, në të cilën njerëzit këndonin në gjuhë. Harmonia, të cilët e krijonin ato zëra, ka qenë e mrekullueshme – kjo më ka prekur thellë. Fillova të qaj; kuptova se qëndroj në tokën e shenjtë. Pas disa ditësh vijova seminarin Jeta në Shpirtin Shenjt. Pas nja pesë javësh te unë u rrit entuziazmi dhe ndjenja se do t'i pranoj të gjitha që Shpirti Shenjt ka për mua – duke përfshirë këtu edhe gjuhët.

Kur erdhi koha që të luten mbi mua për pagëzimin me Shpirt Shenjt, asgjë nuk kam përjetuar. Nuk fillova të luten në gjuhë – u ndjeva e

dëshpëruar dhe e refuzuar. Pas lutjes në të njëjtën natë, një mik u lut që të kem mundësi t'i hapem dhuratës së gjuhës, por përsëri asgjë nuk ndodhi. Kur erdha në shtëpi, u gjunjëzova afër shtratit tim dhe e qita zemrën time para Zotit. Thashë: "E di se Ti dëshirosh të m'i japësh gjithë dhuratat e Shpirtit, prandaj edhe dhuratën e gjuhës. Për këtë të lus edhe një herë për këtë dhuratë". Dhe derisa kam filluar që të lëviz buzët, gjuha e mrekullueshme me plot butësi dhe dashuri filloi që të derdhej nga unë deri sa këndoja në gjuhë të ndryshme. Lotët rridhnin fytyrës sime, sepse në brendësi ndieja lehtësim të madh. Kam qenë e bindur se i këndoj Atit në shpirt. Këtë kam vazhduar ta bëj dy - tri orët e mëvonshme. Kam pasur frikë që të ndalem, sepse mendoja se do të humb dhurata nëse do të ndalem. Mirëpo mëngjesin e ardhshëm jam zgjuar me zemrën përplot gëzim, duke kënduar në gjuhë.

Rosemary

Kur kam filluar të shkoj në takimin e lutjeve, kam qenë shumë skeptike për dhuratën e gjuhëve. Megjithatë, për shkak të gëzimit që ndieja në takimin e lutjeve, kam vazhduar të shkoj, por nuk e kam dëshiruar lutjen në gjuhë. Në një seminar udhëheqësi na ka nxitur që të themi rrokje. Njëra nga ato më tha: "Ti e ke". Mendova: "Po, kam vetëm atë çka kam përsëritur prej teje". Ajo insistonte se unë e kam dhuratën e gjuhës. Përsëri mendova: "Po, zonjushë, si thua ti". Me të vërtetë dyshoja dhe kisha ndjenjën sikur dëshirojnë të më imponojnë diçka.

Nuk kam mundur që t'i jepem plotësisht kësaj dhurate, sidomos jo para njerëzve të tjerë. Kam mundur vetëm me një mikeshën time Rosemary, e cila më ka nxitur pandërprerë. Me te edhe kam filluar për t'u lutur në gjuhë të ndryshme.

Ende dyshoja dhe nga pak isha e hidhëruar në Zotin, sepse ndieja se nëse do të lutem në gjuhë, do të lutem vetëm për atë që Ai dëshiron, por jo për nevoja të mia.

Një mbrëmje nuk munda askënd ta marr në telefon, por me të vërtetë kam pasur nevojë për dikë që të lutet me mua. Më kujtohet se mendova: "Nuk besoj në këtë, por prapë se prapë do të lutem vetë për vete, me duart mbi kokën time", jam lutur ashtu nja dhjetë minuta. Pas një sekonde dëgjova dikë në derë. Ishte Rosemary. Më pyeti: "brenda je mirë?". "Jo, nuk jam" iu përgjigja. Më tha se ka vrapuar prej restorantit në të cilin ishte duke ngrënë darkë, sepse kishte ndier se duhet të jetë me mua.

Atëherë kam filluar të besoj, se kur lutem në gjuhë, Zoti me të vërtetë përgjigjet në nevojat e zemrës sime. Kam filluar të besoj edhe në dhuratën e gjuhëve, në të cilën lutem edhe për nevoja të mia e jo vetëm për nevojat e të tjerëve.

Brenda

Vonë në mbrëmje pas lutjes, në një të premtë në dhjetorin 1971, e kam pranuar pagëzimin me Shpirt, bashkë me bashkëshortin tim dhe, më së paku, edhe me 50 njerëz të tjerë. Të gjithë kemi qenë pjesëmarrës në seminarin Jeta në Shpirtin Shenjt të universitetin Loyola në New Orleans. Nuk kam qenë as vetë e sigurt se çka kam pritur në këtë seminar. Kur të gjitha u kryen, ndieja paqe të madhe, por edhe lodhje. Isha e gëzuar se po shkonim në shtëpi. Në kohën kur janë lutur për ne që të pranojmë pagëzimin në Shpirtin Shenjt, kam pranuar edhe disa zëra të paqartë. Këtë e kam pranuar si folje në “gjuhë të ndryshme”, sepse na kanë mësuar ashtu. Ato zëra i kam përsëritur për disa ditë, por asgjë më shumë nuk ka ndodhur.

Në atë kohë biri ynë i vogël kishte katër vjet dhe çdo mëngjes ai shikonte Rrugën Sezam. Derisa ai shikonte TV, unë atë kohë e shfrytëzoja për lutje. Edhe pse dera e dhomës sime ishte e mbyllur, dëgjoja zërin e televizorit – atë që e quaja dhuratë e gjuhës ka qenë shumë e ngjashme me atë që Muppet nga seria këndonte “Ma na ma na”. Kështu u binda se kjo nuk ka qenë gjuhë e lutjes, por zëra që unë vetë i imagjinoj. E thirra një udhëheqëse të seminarit dhe i thashë se si ndihem. Të dyja qeshëm me këtë përvojë timen, por ajo përsëri më nxiste që të vazhdoj lutjen në gjuhë. Më thoshte se nuk guxoj t’i lejoj të Keqit (Djallit) që të më mashtrtojë. Rashë në dakord me te dhe nja dy ditë vazhdova që të lus të njëjtat rrokje. Pasi që isha e padurueshme, i thashë Zotit, se duhet të m’i japë edhe disa fjalë dhe rrokje nëse nuk dëshiron që të heqë dorë, sepse më duket marri të përsëris të njëjtën gjë. Zoti i dashur, në dashurinë dhe kuptimin e vet, duke ditur zemrën time dhe papjekurinë, ma plotësoi dëshirën në të njëjtin moment. Dhurata e gjuhës filloi të zhvillohet shumë shpejt.

Jam e gëzuar se mund të them se kjo dhuratë e bukur brenda meje manifestohet jo vetëm në lutje, por edhe në këngë. Për mua është vërtet bekim i madh; me siguri edhe për të tjerët – sigurisht shumë më tepër se sa mund të kuptoj.

Charlene

Vetë Zoti më ka marrë dhe më ka vënë në Ripërtëritje. Nuk jam lutur për këtë. Nuk kam ditur si të lutem. Isha ulur në shkallë, kur janë lutur tre persona për mua – Zoti më ka mbushur dhe më ka prekur atë ditë. Të premtën e ardhshme shkova në lutje tek disa njerëz në shtëpi. Atje ishin afër 25 persona. Vëllai im në atë kohë ka qenë në shtëpi, kështu që kemi shkuar së bashku, ai, nëna jonë dhe unë. Sa i mrekullueshëm është Zoti! dërgoi vëllanë tim që nga Alabama që të kishte mundësi të më prekte atë mbrëmje.

Atë natë, të gjithë ata, vendosën se unë duhet ta pranoj dhuratën e gjuhëve. Më ulën në një ndenjësë dhe ata të pestë janë lutur për mua atë

natë të nxehtë. Në të vërtetë, as nuk dija se çka janë duke bërë ata, por qaja si fëmijë deri sa ata luteshin për mua. Mendoja për faktin se sa më duan të gjitha ata njerëz. Rrija në atë ndenjësë dhe papritmas i dëgjova ato zëra që i kisha dëgjuar para një jave. E dija se është dhurata e gjuhëve, sepse kisha lexuar librin Ata flasin në gjuhë të ndryshme të John Sherrill-it. Nuk e dija çka është kjo në të vërtetë; dija vetëm se vjen nga Shpirti Shenjt dhe dëshiroja gjithçka që vjen nga Shpirti. Rrija në atë ndenjësë dhe asgjë nuk ndodhi. Zemra mu thye; mendova se jam mëkatore, e prishur, jo mjaft e shenjtë. Qava përsëri.

Atëherë e kthyen në shtëpi fëmijët e të zotit të shtëpisë, në të cilën luteshim. Më i madhi kishte 14 vjet. U ul dhe ne të gjithë e rrethuan duke u lutur. Pas dy minutash ai lutej në gjuhë të ndryshme Pas tij u ul vajza dhe pas dy minutash ajo kishte dhuratën e gjuhëve. Atëherë i erdhi radha fëmijës së tretë. U ul - por nuk hyri ashtu lehtë në këtë dhuratë, atëherë fillova të lutem në qetësi: "O Zot, epja Stevenit atë dhuratë, të cilën unë nuk jam e denjë për ta pranuar!". Në njëtin moment ai foli në gjuhë. Pas tij, vogëlushja. Ajo, po ashtu nuk e pranoi menjëherë dhe thashë të njëjtën lutje edhe për te. Gati në të njëtin moment, kur lutja kaloi nëpër mendjen time, ajo hyri në dhuratën e gjuhëve. Për pak rashë në dysHEME – posa lutesha, ata e pranorin, por vetë nuk e kisha liruar gjuhën time aq sa duhet.

Të nesërmen, vëllai edhe unë shkuam për t'u lutur me një grup meshtarësh. Para se të shkoja, bëra një dush dhe atje e pranova këtë dhuratë – në banjo. Zoti me të vërtetë ka ndjenjë për humor, apo jo? Kjo është pjesë e tij që ne shpesh e harrojmë – gëzimi dhe humori.

Kur pranova dhuratën e gjuhëve, tingëllonte si timpanet afrikanë – bum, bum. A dyshova? Kurrsesi. Prodhoja zëra si kurrë më parë në jetë. E kam dëshiruar lutjen në gjuhë dhe jam lutur sa herë që kam pasur rast. Kjo ka zgjatur afër katër javë. Atëherë vëllai im u kthye në Alabamë. Një ditë u ula dhe lutesha në gjuhë; papritmas; nuk ishin më timpanet. E thirra vëllanë në Alabamë dhe i thashë: "Bob, u zhdukën timpanet! Po flas në gjuhë, them fjalët". Ai qeshi dhe tha: "Natyrisht, nëse je e durueshme që të lutesh në gjuhë, dhurata jote do të zhvillohet. Mos u çudit nëse ndërrohet edhe shumë herë".

Dottie (motra e Robert DeGrandis, vër. e përkth.)